



UDHËZUES DIDAKTIK

“Asistent Juridik”

**Viti Akademik
2019-2020**

FAKULTETI I DREJTËSISË

FAKULTETI KU “KUALITETI ËSHTË LIGJ”!

Axhenda e studentit:

Emër _____

Mbiemër _____

Libreza e studentit _____

Karta _____

Karta e bibliotekës _____

PUNOI DHE REDAKTOI:

Koordinatorë e programit, Meri Kraja,
Flavia Kolleshi,
Gerta Gjeta



FAKULTETI I DREJTËSISË

FAKULTETI KU "KUALITETI ËSHTË LIGJ"!

Ky publikim është një instrument i vyer për të gjithë studentët e Fakultetit të Drejtësisë të Kolegjit Universitar "Wisdom", këtu do gjeni informacionet e nevojshme për programin e studimit me karakter profesional në "Asistent Juridik".

Duke analizuar planet e studimeve ju jepet mundësia, të përzgjidhni programet didaktike që ju përshtaten më shumë, me qëllim përvetësimin e njohurive të përgjithshme dhe atyre specifike që një të riu i interesojnë sot.

Fakulteti jonë mundëson disa disiplina dhe aktivitete, ku përfshihen laboratore, praktika; etj, që ju lejojnë të përvetësoni një formim profesional dhe fleksibël në mënyrë që të integrohni me efikasitet në tregun e punës.

Jemi një fakultet që jetojmë të tashmen por që jemi të pasuruar dhe me të shkuarën, kjo për hir të dinamizmit dhe cilësisë të profesorit dhe kërkuesve shkencorë, si dhe për figurat e shquara që kanë themeluar Fakultetin (mes të cilëve mund të përmendim, Paolo Foresti, Shefqet Muci etj.)

Kjo axhendë do t'ju ndihmojë të orientoheni në Fakultetin tonë! Ndërsa impenjimi ynë do të bëjë të mundur që Fakulteti i Drejtësisë të jetë për ju Fakulteti ku kualiteti është ligj!

Dekani
Prof.as. Dr. Naim MËÇALLA

Koleji Universitar "Wisdom", me Urdhërin Nr. 369, datë 05.07.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, hapet programi i studimit me karakter profesional në "Asistent Juridik". Fakulteti i Drejtësisë ka si qëllim aktivizimin e subjekteve akademike dhe specialistëve nga më të njohurit për realizimin e një formimi modern në fushën e drejtësisë dhe ligjit, në përputhje me standardet evropiane dhe përvojat e vendit, duke zbatuar specifikat përkatëse në lidhje me arsimin ligjor. Mësimdhënia reflekton standarte perëndimore dhe pedagogët tanë janë konkurues në tregun akademik shqiptar.

Orientimi!

*Ditët e
orientimit*

*Universiteti
me dyer të
hapura*

*Takime
student
docent*

*Guida e
studentit*



Objektivat e vitit

Projektet

Si të realizoj objektivat ?

- ✓ _____
- ✓ _____



Objektivat financiare



Të lexoj ?

- 1
- 2
- 3
- 4

Skadencat didaktike



KOLEGJI UNIVERSITAR WISDOM

PJESA I INFORMACION I PËRGJITHSHËM



FAKULTETI I DREJTËSISË
Fakulteti ku “Kualiteti është Ligj”!

ORGANET QË QEVERISIN FAKULTETIN

Dekani

Prof.as. Dr. Naim MËÇALLA

**Përgjegjësi i Departamentit
Publik**

Dr. Spiro BUDO

**Përgjegjësi i Departamentit
Privat**

Dr. Elmaz SHERIFI

**Përgjegjësi i njësisë së
kerkimit shkencorë dhe
marëdhënieve me jashtë.**

Dr. Irna DOBI

Konsutohu me sitin e
Fakultetit!
www.wisdom.edu.al

Për më shumë
informacion, drejtohu
në sekretarinë
mësimore!



Kolegji Universitar
"Wisdom" - Faqja Zyrtare

SEKRETARIA MËSIMORE

Adresa: Rruga “Medar Shtylla”, Komuna e Parisit, Tiranë
Tel: 04 2200063
Cel: 0676022736
e-mail www.wisdom.edu.al
Orari Nga e hëna në të premte 09:00-20:00
Përgjegjëse e sekretarisë: Anjeza Osmani

Sekretaria mësimore e Kolegjit Universitar “Wisdom” realizon disa shërbime që vijnë në ndihmë të studentit, si për shembull: regjistrimin dhe matrikullimin e studentit, sistemimin e mbajtjen sekret të të dhënave të tyre. Sekretaria mësimore shpall orarin e mësimëve, praktikave, konsultimeve, provimeve duke ndjekur në vijshmëri edhe zbatimin e tyre.

SALLAT E LEKSIONEVE

Godina kryesore tek (A) Rruga “Medar Shtylla”, Komuna e Parisit, Tiranë.

- kati i katërt , sallat 8, 9,10 (për ciklin e parë të studimeve)
- kati i tretë, sallat 4,5,6,7 (për ciklin e dytë të studimeve)

ZYRAT E PROFESORËVE

Godina sekondare (B) tek Rruga “Medar Shtylla”, Komuna e Parisit, Tiranë.

<i>Dekani</i>	<i>zyra nr 7</i>
<i>Përgjegjësi i Departamentit Privat</i>	<i>zyra nr 3</i>
<i>Përgjegjësi i Departamentit Publik</i>	<i>zyra nr 1</i>
<i>Përgjegjësi i njesisë së kerkimit shkencorë dhe marëdhënies me jashtë.</i>	<i>zyra nr 2</i>

Orari i takimeve me profesorët

09:00-15:00

BIBLIOTEKA

Shërbimi i bibliotekës ju mundëson një mjedis dhe ambient studimi, materiale dhe literaturë që u vijnë në ndihmë studentëve. Kjo bibliotekë ndodhet në katin e dytë të universitetit. Në të mund të gjendet çdo material që është i nevojshëm për studentët dhe stafin.

Biblioteka zotëron materiale të llojeve të ndryshme, siç janë libra, gazeta, revista, shkrime, botime. Gjithashtu u mundëson përdorimin e librave elektronikë, si dhe përpilim të dhënash të ndryshme.

Të gjithë anëtarët e stafit të bibliotekës mund t'ju vijnë në ndihmë për çdo kërkesë që ka lidhje me materialet që kërkoni. Biblioteka qëndron e hapur dhe e disponueshme çdo ditë nga ora 8:30 deri në orën 4:30.

BIBLIOTEKA TË TJERA

Bibliotekën Nr.4 të Njësisë Bashkiake Nr.9

Adresa: Rruga Mine Peza

Në total kjo bibliotekë disponon afërsisht 16,000 copë libra.

Kjo bibliotekë ka gjithsej 8 vende studimi.

Biblioteka e Akademisë së Shkencave

Adresa: Sheshi Fan Noli, ngjitur me Kuvendin.

Biblioteka e Akademisë së Shkencave ka një trashëgimi rreth 65 000 vëllimesh periodike, të cilët mbulojnë të gjitha subjektet e kërkimit shkencor.

Kontakt: Tel :04 259 658

Biblioteka Kombëtare

Adresa : Sheshi Skënderbej, pranë Pallatit të Kulturës

(Pallati i Kulturës)

Salla Shkencore;

Salla e Periodikut;

Salla "Paolo Petta";

Këndi Amerikan.

(Rruga Xh. Ë. Bush)

Salla Gjermane

Salla Shkencore

Kontakt: Tel :04 223 843 / 269 954 / 247 482 / 269 955

Tel/Fax : 04 257 670

Biblioteka e Universitetit të Arteve

Biblioteka e Universitetit të Arteve është biblioteka më e madhe dhe më e vjetra e artit në Shqipëri.

Fondi i Bibliotekës së Universitetit të Arteve përmban rreth 35,000 vëllime. Pjesa më e madhe e fondit është unikalë.

Kontakt :

Tel/Fax: +355 4 2 255 721

KURSET – FILLIMI DHE MBARIMI

- Semestri 1**
- 14 tetor fillimi i vitit akademik 2019-2020
 - 7 shkurt mbarimi i semestrit të parë
 - 14-17 tetor java e orientimit dhe zgjedhja e lëndëve me zgjedhje.
 - 27-31 Janar minisezoni i provimeve të mbartura
 - 10 shkurt-28 shkurt sezoni i provimeve dimërore
- Semestri 2**
- 2 mars fillimi i semestrit të dytë
 - 12 qershor mbarimi i semestrit të dytë
 - 25-29 maj minisezoni i provimeve të mbartura
 - 15 qershor-10 korrik sezoni i provimeve verë
 - 29-30 qershor / mbrojtja e praktikave
 - 8/9/10 korrik ceremonia e diplomimit
 - 1-4 shtator regjistrimi për sezonin e provimeve
- 7-20 shtator sezoni i provimeve vjeshtë
 - 21 shtator dorëzimi i diplomave për sezonin e vjeshtës
 - 24-25 shtator diplomimi

Orari

Lënda	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____

Shënim: _____

Semesti
1

Orari

Lënda	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____

Shënim: _____

Semesti
2

PJESA II

INFORMACION

MBI PROGRAMIN E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL
“ASISTENT JURIDIK”



“ASISTENT JURIDIK”

Programi i Studimeve Profesionale të Larta “Asistent Juridik” synon të sigurojë një aparat të plotë dhe të fokusuar duke profilizuar studentët në fusha të ndryshme të drejtësisë, duke i përgatitur ata për kompetencat fillestare të punësimit.

Ky program u mundëson studentëve të fitojnë dijet e nevojshme për t’u ballafaquar me problemet juridike lidhur me

legjislacionin në fuqi, në fushat penale, publike, dhe private të konkretizuara në disiplina si: kushtetueshmëria, organizimin dhe funksionimin e administratës publike, procedurave ligjore dhe gjyqësore, familjare etj.

Objektivi kryesor i këtij programi studimi është që në përfundim të formojë ekspertë dhe specialistë të mirëfilltë që punojnë në kontakte të ngushta me Avokatët/ Juristët, duke përdorur instrumenta më të përparuar në ndihmë të avokatit dhe jo vetëm.

Programi Profesional “Asistent Juridik” është me natyrë të fokusuar aplikative dhe ofron formim kryesisht praktik për arritjen e objektivave profesionale në fushën juridike me synimin e pajisjes së studentit me aftësi dhe njohuri të kuadrit zbatues ligjor në fushën e drejtësisë për të garantuar një karrierë të suksesshme profesionale.

Në fund të studimeve, studenti do të jetë i gatshëm për të shërbyer në sektorë të ndryshëm në fushat e së drejtës dhe ligjshmërisë, si njohës i mirë i legjislacionit në fuqi dhe problematikave përkatëse juridike gjyqësore dhe zgjidhjeve të tyre, në sfera të rëndësishme të praktikës gjyqësore.

NJOHURITË DHE KOMPETENCAT E STUDENTËVE NË PËRFUNDIM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Ky program studimi përgatit specialist me cilësi dhe shprehi të larta teknike dhe profesionale drejt një karriere të suksesshme, në përputhje me modelet dhe vizionet bashkëkohore të strukturave institucionale publike dhe private, në kontekstin e globalizimit dhe integritimit evropian. Synojmë të formojë një brez të kualifikuar që njeh mirë bazat e së drejtës dhe menaxhon dosjet juridike si dhe fiton aftësi dhe teknika në hartimin e akteve dhe shkresave juridike që i paraqiten Gjykatave, Administratës si edhe të tretëve.

Në përfundim programi i studimit formon :

- a) Ekspertë dhe specialistë të mirëfilltë që punojnë në kontakte të ngushta me avokatët, duke përdorur instrumenta më të përparuar në ndihmë të avokatit dhe jo vetëm;*
- b) Profesionistë të aftë në formulimin e dokumentave si psh: kërkesa, kallëzime, kërkesë padi, ankime, rekurse, akte që i nënshtrohen veprimeve noteriale etj.;*
- c) Specialistë të aftë në formulimin dhe hartimin e kontratave të huasë, qirasë, shërbimeve etj.;*
- d) Espertë në mbajtjen e evidencave për proceset gjyqësore dhe përmbarimore, si dhe përpilon akte nën këshillën e juristit/avokatit;*
- e) Specialistë të aftë në mbajtjen e korespondencën, axhendës së takimeve me palët e treta, skadencat administrative dhe të njohin nga afër praktikën juridike.*



MUNDËSITË PËR PUNËSIM

Pas përfundimit të këtij programi studimi, në sajë të njohurive të marra, studenti ka akumuluar gjithë aftësitë e nevojshme si Asistent Juridik me një nivel bazik njohurish teorike dhe praktike, duke bërë që një diplomë e tillë të mundësojë punësimin pranë:

- a) Zyrave të Avokatisë;*
- b) Studiove Ligjore;*
- c) Zyrave të Ndërmjetësisimit;*
- d) Zyrave të Noterisë ;*
- e) Zyrave të Përmbarimit Gjyqësor;*
- f) Kompanive /organizatave private apo publike vendase ose të huaja;*
- g) Institucioneve në nivel qendror dhe lokal;*
- h) Enteëve, agjensive dhe shoqatave, etj.,*

Me kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

KOMPONENTI MËSIMOR	LËNDA	ETCS
LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (A)	E drejtë publike	6
	Bazat e Ligjshmërisë dhe e Drejta Kushtetuese	6
	E drejtë Romake	6
LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore (B)	Ekonomi Tregu	4
	Shkrim dhe arsyetim ligjorë	4
	E drejtë civile MOD 1/ MOD 2	12
	E drejte penale e përgjithshme	6
	E drejtë penale e posaçme	6
	E drejta Administrative	6
	E drejta e Detyrimeve	6
	E drejta e Punës	4
	E drejta Tregtare	4
	E drejtë Familiare	4
	Procedurë Civile	5
Procedurë Penale	5	
LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C)	Filozofi e së drejtës Logjik Formale Histori institucionesh E drejta e migracionit E drejta Europiane Arbitrazhi dhe profesionet e lira	4/4
	Histori e shtetit dhe së drejtës Hartim Kontratash E drejtë Financiare Edrejta ndërkombëtare publike Edrejta ndërkombëtare private	4/4
LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D)	Gjuhë e huaj I	4
	Njohuri Informatike	4
	Praktika profesionale	8
DETYRIME PËRMBYLLËSE (E)	Provimi i përgjithëm përfundimtarë	4

KUJDES: Respektoni datat për lëndët me zgjedhje!

PROGRAMI I STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL “ASISTENT JURIDIK”

Përshkrimi i lëndëve

VITI I

E drejtë publike
6/ ECTS

E drejta publike studion ligjet e lindjes dhe zhvillimit të shtetit dhe se drejtes , ligjet shoqerore qe percaktojne vetite, karakteristikat dhe tiparet specifike te shtetit dhe se drejtes, lindjen dhe ndikimin e tyre te ndersjellte, Duke studjuar ne lidhje te ngushte shtetin dhe te drejten, kjo lende shtjellon nje sere problem themelore te tyre si origjina, permbajtja shoqerore, tipat historike te shtetit dhe se drejtes , format e tyre te vecanta ne jeten shoqerise. E drejta publike eshte shkenca mbi ligjet e lindjes e zhvillimit te shtetit dhe se drejtes , ligje qe i studion ne format konkrete te shfaqes se tyre. Objekti i lendes e drejta publike, si nje shkence shoqerore, jane fenomenet shteterore dhe juridike, konceptet themelore te shkencave te shtetit dhe se drejtes, te cilat shtjellohen me tej ne lendet e tjera juridike. Qellimi i ketij kursi eshte t'i pajise studentet me nocionet e para te shtetit dhe se drejtes , qe do tu sherbejne per studimin dhe kuptimin e lendeve te tjera juridike,

E Drejta Romake
6/ ECTS

Kursi i së drejtës romake, nëpërmjet prezantimit elementar të së drejtës romake në evolucionin e saj historik, ka për synim t'i ofrojë

studentit një hyrje të përgjithshme në studimin e së drejtës.

Institucionet e së drejtës romake studiojnë tërësinë e normave juridike që kanë rregulluar jetën e qytetarëve romakë nga themelimi i Romës (753 p.e.s) deri me vdekjen e Justinianit (565 e.s.), praktikisht përgjatë pothuajse njëmijë e katërqind viteve. Gjithashtu ky kurs ofron mundësinë për të ndjekur transformimet e një sistemi juridik që – edhe pse besnik ndaj parimeve të veta – diti të modifikohej thellësisht, duke iu përshtatur ndryshimeve sociale, ekonomike dhe politike që transformuan një tubim barinjsh në një Perandori që do të dominonte botën.

E Drejta Civile
(Modul 1-Pjesa e Përgj dhe
Modul 2-Drejta e Pronësisë)
6/6 ECTS

E Drejta civile, pjesa e përgjithshme si dhe e posaçme, është një nga lëndët bazë në formimin e juristëve të ardhshëm. Përmes kësaj lënde studentët marrin njohuritë bazë për institutet më të rëndësishme të kësaj të drejte si nocionet paraprake lidhur me të drejtën civile, kuptimi i marrëdhënies juridike civile, mjetet e mbrojtjes të drejtave subjektive civile të shkelura si dhe trajtimi i instituteve të pjesës së përgjithshme të së drejtës civile si subjektet e së drejtës, përfaqësimi, veprimet juridike e parashkrimi i padisë si dhe disa institute lidhur me pronësinë, të drejtat reale dytësore dhe trashëgimia.

Veçoria e tematikave të kësaj lënde është se trajtimi i instituteve të saj shërben si një parakusht tepër i rëndësishëm për të kuptuar edhe lëndët e tjera që janë të lidhura organikisht me të.

Ekonomi Tregu
4 ECTS

Lënda eksploron teorinë mikro-makroekonomike dhe aplikimin e saj në vendim-marrjen manaxheriale. Egzaminon sjelljen konsumatore, vlerëson koston dhe prodhimin, optimizimin, vendosjen e çmimeve në tregjet konkurrenciale dhe jo-konkrrenciale, vendim-marrjen në kushtë pasigurie dhe sigurie.

Bazat e Ligjshmërisë dhe e Drejta Kushtetuese
6 /ECTS

Lënda e “ E Drejta Kushtetuese “ ka një rendësi të veçantë për vetë faktin se rregullon marrëdhëniet midis individit dhe organeve të qeverisjes, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sistemin e qeverisjes, sistemin normativ, ku konkretizohet lidhja e normave ndërkombëtare me ato të brendshme, dhe veçanërisht zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Ndër temat që e “Drejta Kushtetuese” trajton përmendim: Burimet e të drejtës Kushtetuese;

Dimensioni ndërkombëtar i të drejtave të Njeriut; aktet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut; Klasifikimi i të drejtave dhe liritë të Njeriut; Sistemi i zgjedhjeve të organeve përfaqësuese të popullit; Parimet bazë të zgjedhjeve; Garancitë; Format e ndryshme të qeverisjes në një Demokraci; Demokracite Parlamentare dhe Presidenciale; funksioni politik, normativ dhe administrativ, etj.

Shkrim dhe arsyetim ligjorë

Qëllimi kryesor i lëndës është të njohë

4 / ECTS

studentët me konceptet bazë të komunikimit dhe të shkruarit akademik. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet detyrave të ndryshme praktike, leksioneve, diskutimeve, leximit, materialeve apo librave të ndryshëm, që mund të përfshijnë edhe materiale të botuara në median e shkruar. Studentët do të fitojnë shprehi të terminologjisë shkencore, që përdoret në të kuptuarin, të shprehurit dhe shkruarin akademik. Studentët do të arrijnë të shkruajnë detyrat e ndryshme, që do të kenë gjatë viteve të studimeve të shkollës së lartë, si dhe do të njihen me strukturën e punimeve shkencore, siç është punimi i diplomës. Një qëllim tjetër shumë i rëndësishëm i lëndës është të forcojë më tej të menduarit kritik. Studentët do të inkurajohen të krijojnë prespektiva krahasuese dhe të përdorin të njëjtat mjete dhe forma që përdorin profesionistët në shkencat përkatëse.

Gjuhë e Huaj – Anglisht 4/ ECTS

Gjuha Angleze, e cila zhvillohet si lëndë vjetore me tekstin bazë, “Studying English and Legal English” dhe me tekst mbështetës metodën ‘Cutting Edge Elementary’, Legal English 1, prezanton strukturën e teksteve me bazë juridike dhe fjalorin e fushës së shkencave juridike. Lënda ka si synim t’u mësojë studentëve se si të lexojnë, punojnë dhe përdorin tekste origjinale në gjuhën angleze. Me anë të teksteve me përmbajtje juridike studentët do të zhvillojnë një kuptimësi më të mirë të gjuhës së shkencave shoqërore dhe do të

praktikojnë njohuritë në punët e tyre krijuese si ese, ilustrime të ndryshme formuese, ushtrime etj. Objektivi kryesor i lëndës është gjithashtu edhe përfundimi i aftësive për të shkruar, që do të realizohet me anë të strategjive së të shkruarës në gjuhën angleze duke përdorur terminologjinë e fjalorit juridik.

Njohuri Informatike 4/ ECTS

Lënda Njohuri Informatike i pajis studentët me njohuritë nevojshme për lëvizshmëri tepër të shpejtë të informacionit.

Ndikimi i teknologjisë – veçanërisht avancimi i komunikimit dhe informatizimit – krijon mundësi për lëvizje të punës, kapitalit dhe teknologjisë nga një vend në vendin tjetër. Do të përshkruhet dhe analizohet lidhja midis programeve kompiuterike, biznesit dhe shoqërisë. Si mund të përdoret programe kompiuterike për të përmirësuar vendimmarrjen, punët dhe mbarëvajtjen e institucionit.

E drejte penale e përgjithshme 6/ ECTS

Në lëndën e të Drejtës Penale (Pjesa e Përgjithshme), si një nga lëndët formuese profesionale, studiohen konceptet e ligjit penal dhe zbatimit të tij në praktikë; bazat, detyrat, parimet dhe interpretimi i legjislacionit penal; ndërtimi i normave penale juridike; ndarja e veprave penale në krime dhe kundërvajtje; dhe veprimi i ligjit penal në kohë dhe në hapësirë. Studenti asimilon njohuritë e nevojshme mbi elementet e kuptimit të veprës penale (objekti, subjekti, ana objektive dhe ana subjektive, përfshirë moshën për përgjegjësi penale, lidhjen

shkakësore, fajin në format e tij të dashjes dhe pakujdesisë); mbi kryerjen e veprave penale në bashkëpunim; mbi kuptimin, qëllimin, sistemin dhe llojet e dënimeve penale (kryesore dhe plotësuese); mbi rrethanat e ndryshme në të cilat kryhen veprat penale; mbi caktimin e dënimit; si dhe mbi institutet e shuarjes së ndjekjes penale, të parashkrimit, rehabilitimit, faljes dhe amnistisë.

LËNDË ME ZGJEDHJE (2)

Filozofi e së drejtës
4/ ECTS

Filozofia e së Drejtës është lëndë teorike shumë e nevojshme për studentët, për të njohur teoritë dhe shkollat e ndryshme filozofike mbi historikun e lindjes dhe evoluimit të institutit të së drejtës, sidomos në shekullin e XX, dhe për ta interpretuar të drejtën pozitive/objektive, me metodat e logjikës formale, duke përdorur gjykimin, arsyetimin e sidomos silogjizmat.

Logjik Formale
4/ ECTS

Lënda ka si qëllim të përcjellë tek studenti i Drejtësisë, pavarësisht nga profili, korrektësinë e të menduarit drejtë, pa gabime të karakterit logjik. Nëpërmjet njohjes së tij, të kuptimit dhe formimit të konceptit si dhe përkufizimit të tij, mund të evitohet mundësinë e dykuptimësisë së një koncepti dhe për rrjedhojë edhe të mosmarrëveshjeve. Logjika, me metodat e njohjes shkencore, gjithashtu jep mundësinë e gjetjes së rrugës së drejtë e të besueshme për të vërtetën në kryerjen apo analizën e një ngjarje, të gjurmëve të një krimi, e për pasojë, një hetim të plotë të tij. Arsyetimi, llojet e tij, sidomos induksioni e deduksioni, e pajisin juristin e

Histori Institucionesh 4/ ECTS

ardhshëm me një mundësi më shumë të nxjerrjes së konkluzioneve të drejta, të vërteta dhe të shpejta.

Historia e institucioneve është një lëndë e rëndësishme për formimin e juristeve të ardhshëm duke i përgatitur studentet në ndjekjen e programit universitar. Si fushë e vecantë studimore, ajo është relativisht e re sepse zhvillimi i saj i përket shekullit tonë dhe sidomos periudhës së pas Luftes së DytëBotërore. Ajo ka për objekt studimin dhe përshkrimin e evolucionit të rregullave dhe të strukturave juridike në raport me marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore, duke i studiuar ato më teper në thelbin dhe në realitetin e tyre se sa në paraqitjen e tij teknike. Në objektivat kryesore të lëndës bën pjesë njohja me evolucionin historik të institucioneve dhe të së drejtës në Europë. Qëllimi i kësaj lënde është ti ofrojë studentëve njohjen me fillesat, zhvillimin dhe evoluimin e institucioneve që nga kohët antike, Lindja e Lashtë e duke vazhduar me Athinën dhe Romën e lashtë e deri në ditët tona.

Arbitrazhi dhe Profesionet e lira 4/ ECTS

Lënda e Arbitrazhi dhe profesionet e lira është një nga disiplinat komplementare të rëndësishme të programit mësimor, teorik dhe praktik e cila ka për qëllim të formojë studentët dhe juristat sa më të kualifikuar në të ardhmen. Trajtimi i temës së Arbitrazhit është i një rëndësie të veçantë dhe i domosdoshëm për vetë problematikën që paraqet, sepse vihet re një rritje e konflikteve në këtë fushë. Profesionet e

Lira i referohen një aktiviteti intelektual dhe profesional i kryer nga specialistë si Avokati, Noteri dhe Përmbaruesi të cilët kryejnë një veprimtari të pavarur, por të rregulluar ose vetërregulluar nga ligjet përkatëse ose nga statutet e Dhomave Kombëtare (Avokatisë, Noterisë, Përmbarimit), të pajisur me leje (licencë) të lëshuar nga organet kompetente

E drejta e Migracionit 4/ ECTS

E Drejta e Migracionit është një fushë e re e së drejtës e cila është zhvilluar me ritme të shpejta gjatë dy dekadave të fundit. Në Shqipëri, legjislacioni migrator është hartuar kryesisht pas viteve '90. Për pasojë, ka një mungesë të informacionit në këtë fushë specifike të së drejtës. Duke marrë në konsideratë se gjithmonë e më shumë Shqipëria po bën përpjekje për përfaqsimin e legjislacionit migrator me legjislacionin Evropian dhe atë nderkombëtar, si dhe nevojën për ekspertizë në këtë drejtim, lënda synon të informojë studentët me konceptet bazë të së drejtës migratore, si në aspektin teorik, ashtu edhe atë praktik. Ashtu si në pjesën më të madhe të vendeve, edhe në Shqipëri gradualisht po ndihet nevoja e juristëve apo avokatëve me njohuri të specializuara në fushën e migracionit, për pasojë, lënda synon t'i pergjigjet nevojave dhe zhvillimeve të tregut të punës.

E drejta Europiane 4/ ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është t'ju mundësojë studentëve një njohje të thellë të çështjeve të së Drejtës të Bashkimit Evropian. Studimi i të Drejtës Europiane paraqet një rëndësi të vecantë jo vetëm studimore, por edhe praktikë sidomos për vende të tilla si Shqipëria të cilat synojnë anëtarësimin në BE. Nga ana

tjetër, studimi i kësaj të drejtë paraqet rëndësi studimore dhe praktike edhe për vendet e tjera për shkak të veçorive unike që paraqet. Më konkretisht, BE mishëron një formë unike të bashkëpunimit dhe qeverisjes të 27 vendeve anëtare me mbi 400 milion njerëz. Kjo lëndë është konceptuar gjithashtu për të shpjeguar karakteristika e BE dhe mënyrën sesi e Drejta Evropiane ndikon në vendet anëtare dhe në qytetarët e tyre. Pavarësisht, natyrës gjithëpërfshirëse, kjo lëndë do të përqendrohet kryesisht në çështjet e të Drejtës Evropiane si psh.: Si krijohen normat e së Drejtës Evropiane? Cili është roli dhe pushteti që ushtrojnë institucionet e ndryshme? Po ashtu, nga ky këndvështrim do të studiohen edhe mjetet gjyqësore që mund të përdoren ndaj masave që ndërmerren nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të normave të së Drejtës Evropiane si dhe masave që ndërmerren nga vendet anëtare për zbatimin e këtyre normave.

Viti II

E Drejta Penale (Pj.Posaçme) 6/ ECTS

Lënda përmban leksione mbi kuptimin e përgjithshëm të së drejtës penale të posaçme, dhe mbi grup veprat penale sipas ndarjes në KP si: krimet kundër njerëzimit, veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës si ato me dashje dhe nga pakujdesia, veprat penale që rrezikojnë shëndetin, krimet seksuale, ato kundër lirisë së personit, vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, si vjedhja e pasurisë, mashtrimet, shkatërrimi i pronës, ato në fushën e doganave, në lidhje me taksat e tatimet, ato të falsifikimeve të dokumenteve të ndryshme, në fushën e falimentimit, ato që

cënojnë regjimin e tokës, kundra mjedisit etj.

E Drejta Administrative **6/ ECTS**

Objekti i së Drejtës Administrative shtrihet në studimin e tërësisë së normave materiale e procedurale të së drejtës administrative, të organizimit dhe funksionimit të organeve të administratës publike dhe të kontrollit që ushtrohet mbi këtë administratë përgjatë ushtrimit të funksioneve administrative. Synimet konkrete të lëndës janë: Analiza e parimeve të funksionimit të organeve të administratës publike; Analiza dhe studimi i organeve të administratës publike dhe formave të kontrollit mbi veprimtarinë e tyre si dhe gjendjes juridike të personave fizikë e juridikë në vend Analiza e formave të shfaqjes së vullnetit të organeve të administratës publike: Prezantim i konceptit të aktit administrativ; Analiza dhe studimi i rishikimit gjyqësor të aktit administrative; Analiza e kontratave administrative dhe akteve diskrecional; Studimi i kundëroajtjes administrative: Analiza e procedurës për gjykimin e Kundëroajtjes administrative Analiza e elementeve të procedimit administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Vëmendje e vecantë u kushtohet njohurive ba mbi detyrimet dhe kontratat mbështetur në dispozitat e Kodit Civil Shqiptar duke filluar në neni 419 deri në nenin 1161 si dhe në ligje të tje të botuara që rregullojnë aspekte të vecanta detyrimeve dhe kontratave. Kursi realizohet nëpërmjet leksioneve ku do të bëhet një paraqitje problematikës thelbësore teorike dhe orientimi

E Drejtë e Detyrimeve 6/ ECTS

literaturën përkatëse. Orët praktike do të zhvillohen në trajtën e seminareve, të diskutimeve. Lënda trajton specifikisht tema si: elementet thelbësorë të kontratës, marrëdhënien kreditor-debitor, elementet e marrëdhënies juridike të detyrimit, llojet e detyrimeve, garancitë për përmbushjen e detyrimit, kontratat e kalimit të pronësisë, kontrata e huapërdorjes, kontrata e depozitës, agjensisë dhe ndërmjetësimit, etj.

E Drejta e Punës 4/ ECTS

Programi mësimor i kësaj lënde synon t'i pajisë studentët me njohuri juridike shkencore bashkëkohore si dhe me përvojën përkatëse të vendit tonë e vendeve të tjera demokratike në fushën e marrëdhënieve të punës. Shkenca e së drejtës së punës ka rëndësi veçanërisht të madhe në formimin profesional të juristit. Kjo lidhet me vetë vendin dhe rolin e punës në shoqërinë demokratike dhe përcaktohet nga rëndësia jashtëzakonisht e madhe që ka ajo për ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, të ekonomisë sociale të tregut, të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, etj. Demokracia dhe puna e lirë janë të pandara nga njëra-tjetra, janë të lidhura e të ndërvarura nga njëra-tjetra.

E Drejta Tregtare 4/ ECTS

E drejta tregtare është lëndë e rëndësishme për zhvillimin intelektual dhe profesional të studentëve. Lënda konsiston në trajtimin e legjisllacionit të së drejtës tregtare duke u fokusuar më shumë në shoqëritë tregtare si dhe hapat që ka ndërmare Shqipëria në përafrimin e legjisllacionit të së drejtës tregtare. Kjo është një disiplinë e domosdoshme dhe me një rëndësi të veçantë për programin mësimor, teorik dhe praktik. Ky cikël leksionesh konceptohet për t'i

shërbyer sa më mirë dhe në mënyre më efektive rritjes së nivelit dhe cilësisë të njohurive dhe të aftësive të studentëve në fushën e së drejtës tregtare.

E Drejta Familjare 4/ ECTS

Programi i të drejtës familjare është një program i ndërtuar në përputhje me rëndësinë e vecantë të kësaj fushe të së drejtës e të shkencës juridike. E drejta familjare është një ndihmesë e konsiderueshme dhe përbën një nga faktorët bazë që synon jo vetëm në përvetësimin dhe perfeksionimin e instituteve më të rëndësishme, por dhe zhvillimin e gjuhës dhe mendimit juridik. Programi synon nxënien dhe ndërgjegjësimin e studentëve për kujdesin dhe mbrojtjen e familjes kryesisht nëpërmjet njohjes së legjislacionit shqiptar, praktikës gjyqësore dhe standardeve që kërkon kuadri ligjor i harmonizuar me atë Evropian. Programi jep njohuri teorike dhe praktike, në mënyrë që studentët pas përfundimit të kursit, të jenë në gjendje të interpretojnë e zbatojnë ligjin, të shfrytëzojnë literaturën dhe të kumtojnë mendimet e tyre rreth problemeve të ndryshme të lidhura me to.

Procedurë Civile 5/ ECTS

Qëllimi i studimit të kësaj lënde është studimi i rregullave që dispijlojnë zhvillimin e procesit civil. E drejta procedurale civile si një nga pjesët e së drejtës, studion rregullat e zhvillimit të procesit civil, që bëjnë të mundur të jepet drejtësi duke garantuar si integritetin e rendit juridik, ashtu dhe të drejtat subjektive e materiale të subjekteve të ndryshme, qoftë në marrëdhëniet e tyre reciproke, qoftë dhe kundrejt organeve të pushtetit publik dhe duke

i ofruar këtyre subjekteve mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme. Procedura civile siguron realizimin konkret të të drejtave. Ajo përben një disiplinë autonome. E drejta procedurale civile bën të mundur sigurimin e sanksioneve të të drejtave subjektive individuale por dhe sigurimin e sanksioneve për rregullat e organizatave dhe të funksionimit publik. Procedura civile ka lidhje me të drejtën private, të drejtën publike në masën ku qëllimi i saj është funksionimi i shërbimit publik në drejtësi.

Procedurë Penale 8 /ECTS

Lënda e Procedurës Penale zhvillohet si një kurs i detyrueshëm në degën e Drejtësisë. Në këtë lëndë studenti merr njohuritë e duhura mbi parimet e procedimit penal; për subjektet që veprojnë në këtë fushë të drejtësisë; për juridiksionin dhe kompetencat e tyre; për llojet e provave dhe mjetet e kërkimit të tyre; për masat e sigurimit personal dhe pasuror. Ajo është konceptuar si një disiplinë e rëndësishme për shpjegimin teorik dhe lidhjen me praktikën e të gjitha veprimeve procedurale që duhet të kryhen nga subjektet e procedimit penal gjatë veprimtarisë hetimore; asaj gjyqësore në të gjitha instancat; të ekzekutimit të vendimeve; dhe të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, të lidhura me respektimin e të drejtave të njeriut në luftën kundër krimit dhe dhënien e drejtësisë

LËNDË ME ZGJEDHJE (1)

Histori e Shtetit dhe e se

Lënda përmban shpjegimin e historisë së

drejtës Shqiptare
4/ ECTS

institucioneve më të rëndësishme juridike dhe shtetërore nëpër formacionet e ndryshme historike, prej periudhës antike e deri në periudhën bashkëkohëse. Në veçanti hapësirë e mjaftueshme i kushtohet të drejtës zakonore shqiptare, e cila ka qenë mjaft e zhvilluar dhe e cila ka pasur ndikim në marrëdhëniet juridike familjare, në raportet e gjakmarrjes si dhe në rregullimin e marrëdhënieve pronësore dhe trashëgimore. Në kuadër të historisë e drejta zakonore mësohet si trashëgimi kulturore e popullit shqiptar e jo si mjet për zgjidhjen e kontesteve.

Hartim Kontratash
4/ ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është pajisja e studentëve me njohuri rreth procesit të hartimit të kontratave, rishikimt të tyre etj, në përputhje me nevojat e klientit ose institucionit duke u kujdesur për të shmangur problemet e mundshme ligjore dhe njëkohësisht me qëllimin e posaçëm të parashkimit të rregullimit të çdo çështje të mundshme. Vetë qëllimi i hartimit të një kontrate është hartimi i rregullave të sjelljes sipas vullnetit të palëve lidhur me objektin e kontratës njëkohësisht objekt i mardhënies juridike që rregullon kontrata.

E drejtë Financiare
4/ ECTS

Shkencat mbi financat dhe e drejta financiare, synon të pajisë studentët me njohuri të plota rreth sistemit të të hyrave publike, shpenzimeve publike dhe buxhetit të shtetit. Në kuadrin e të hyrave publike, kjo lëndë studion në mënyrë të hollësishme tatimet, doganat, taksat-si të hyra të zakonshme të shtetit, si edhe huatë publike-

hyrëse jashtëzakonshme. Të gjitha të hyrat publike studiohen te klasifikuar ,studiohet terminologjia që përdoret në çdo ras , parimet në zbatimin e tyre.

E Drejta Ndërkombëtare
Publike
4/ ECTS

Kjo lëndë ka për qëllim të njohë studentët me rendin ligjor dhe institucionet ndërkombëtare duke mundësuar studimin në rrafsh krahasues. Lënda ofron mundësinë e studimit të marrëdhënieve diplomatike të shtetit shqiptar dhe çështjet më të rëndësishme ndërkombëtare në të cilat ka qenë përfshirë shteti ynë. E drejta ndërkombëtare trajton tema dhe koncepte të drejtës ndërkombëtare penale, të drejtës ndërkombëtare humanitare, të drejtës ndërkombëtare mjedisore dhe të drejtës ndërkombëtare detare. Po ashtu një rëndësi të madhe kjo lëndë u jep nocioneve si shtetësi, kombësi, minoritete, pakica kombëtare, azil, diplomaci, luftë, traktat, paqe, armëpushim etj.


E Drejta Ndërkombëtare
Private
4/ ECTS

E drejta Ndërkombëtare Private është një degë e vecantë dhe e spikatur e së drejtës së brëndshme. Kjo lëndë mund të përkufizohet si një tërësi normash juridike që ka për qëllim marrëdhënien juridiko-civile të përzgjedhur midis një numri të pacaktuar rendesh juridike. Tipari dallues në një marrëdhënie juridike civile është shfaqja në tërësinë e pjesëve përbërëse të saj. Nëse do të jepnim një përkufizim për këtë të fundit, atëherë në vija të përgjithshme do të thonim se ai është një aspekt apo rrethanë e caktuar që shfaqet në një marrëdhënie juridike civile duke bërë këtë të fundit më të ndërlikuar se zakonisht. Për këtë arsye dhe zgjidhja apo rregullimi që kërkohet që ti bëhet kësaj marrëdhënie, nuk gjendet si

Praktika profesionale
8/ ECTS

rregull në rendin juridik të cilit i përket marrëdhënia juridiko-civile në fjalë, por shpeshherë në pikën më të afërt të kontaktit që krijon elementi i huaj me një rend juridik të huaj dhe që nëpërmjet kriterit të lidhjes përzgjidhet si i aplikueshëm për rregullimin e marrëdhënies në fjalë

Praktika mësimore përbën një element të rëndësishëm në kurrikul. Praktika mundëson përdorimin e njohurive të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik dhe profesional. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione/organizata/kompani. Përgjatë periudhës së realizimit të praktikës studenti duhet të përdorë dhe përfshijë njohuritë teorike të përfituara me njohuritë praktike për të synuar në këtë mënyrë drejt rrugëve të ardhshme të karrierës. Praktika u krijon studentëve mundësi për njohjen praktike të proceseve dhe procedurave të ndryshme gjyqësore, ankimore, por edhe në hartimin e akteve të ndryshme ligjore.





KOLEGJI UNIVERSITARE WISDOM

Fakulteti i Drejtësisë

Rruga "Medar Shtylla", Komuna e Parisit, Tiranë

04 2200063/ 0676022736

www.wisdom.edu.al